




NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi “Bil Clinton” Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar “Bil Clinton” Br.13 Prishtina, Kosova
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Auditori i Jashtëm

 REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01/3	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	999
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	—	Data Datum Date:	02.05.19
PRISHTINË/A			

Vendimi : (VI)

Miratohet Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Auditori Jashtëm për vitin 2018.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi:	U.D Kryesuesi i BD:
Nënshkrimi	Berat Lushtaku	Liridon Zogjani
Data:26.04.2019		



N.H IBËR LEPENC SH.A

**Pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018**

**dhe
Raporti i auditorit të pavarur**

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	3-5
Pasqyra e pozicionit financiar	6
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	7
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë	9
Shënimet e pasqyrave financiare	10-25

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin dhe pronarin e N.H "IBËR LEPENC" SH.A.

Opinionit me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të N.H "Ibër Lepenc" Sh.A ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2018 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në paragrafin baza për opinion me rezervë, pasqyrat financiare janë paraqitur drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2018 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion me rezervë

- Siç është shpalosur në shënimin 4a. Politikat Domethënëse të Kontabilitetit të kompanisë, Prona, Impiantet dhe Pajisjet deri me 01 janar 2008 barten sipas kostos së vlerësuar minus çdo amortizim dhe humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Pas datës 01 janar 2008 Prona, Impiantet dhe Pajisjet janë vlerësuar sipas modelit të rivlerësimit që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 "*Prona, Impiantet dhe Pajisjet*" ("*SNK 16*"), rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt mjaftueshëm që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit. Rivlerësimi i fundit i Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve të kompanisë është kryer me 31 dhjetor 2007 nga një kompani vlerësuese e licencuar.

Siç është paraqitur në shënimin 6 të pasqyrave financiare Prona, Impiantet dhe Pajisjet mbartin vlerën neto 113,333,055 Euro me 31 dhjetor 2018 (117,741,048 Euro me 31 dhjetor 2017), ne nuk ishim në gjendje përmes procedurave alternative të auditimit të vlerësojmë se vlera bartëse e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve është prezentuar në përputhje me kërkesat e SNK 16. Gjithashtu për shkak çështjeve të lartëcekura ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse rezerva e zhvlerësimit e paraqitur në pasqyrat financiare është të përshtatshme për të pasqyruar vlerën e totalit të Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve në krahasim me vlerën e rikuperueshme të saj.

- Siç është shpjeguar në shënimin 7, Llogaritë e arkëtueshme tregtare prej 1,636,184 Euro me 31 dhjetor 2018 (1,689,212 me 31 dhjetor 2017) paraqesin obligimet e klientëve kryesor të kompanisë. Borxhi i pa arkëtuar nga blerësi kryesor i kompanisë Ujësjiellësi Regjional "Mitrovicë" me 31 dhjetor është 814,844 Euro, nga kjo shumë 57,717 Euro janë borxhe të vjetra më shumë se 3 (tre) vite. Kompania nuk ka njohur lejime specifike për borxhe të këqija duke marrë parasysh se ka borxhe të vjetra, për të cilat kompania ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore. Ne përmes procedurave alternative të auditimit nuk kemi arritur të vlerësojmë shumën e saktë të llogarive që duhet të shlyhen dhe efektin e tyre në pasqyrat financiare. Prandaj gjendja e llogarive të arkëtueshme me 31 dhjetor 2018 është e mbivlerësuar për shumën e borxheve të pashlyera.

Referuar në *Standardin ndërkombëtar të raportimit financiar 9 ("SNRF 9")* kërkohet nga ndërmarrja të njohë një provizion për humbje për përkeqësimin e pritshëm të kredisë të një aktivi financiar për të cilat duhet plotësohen kushtet e çvlerësimit. Ndërmarrja duhet të zbatojë kërkesat e çvlerësimit për njohjen dhe matjen e shumës së humbjes për aktivet financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Sipas SNRF 9 kërkohet që në çdo datë raportimi, një njësi ekonomike të masë provizionin për humbjen e një

instrumenti financiar në atë shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së tij nëse rreziku i kreditit të atij instrumenti financiar është shtuar ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare.

Siç është shpalosur në shënimin 7 Llogaritë e arkëtueshme tregtare me 31 dhjetor 2018 ka vlerën neto 1,636,184 Euro (me 31 dhjetor ka vlerën neto 1,689,212 Euro). Kompania ka paraqitur provizion në vlerë prej 15,408 Euro i cili nuk ka ndryshuar nga periudhat paraprake, gjatë vitit 2018 nuk është njohur ndonjë lejim dhe provizion i përgjithshëm i cili do të reflektonte në pasqyrat financiare. Mos ndarja e lejimeve të përgjithshme dhe mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme sipas kërkesave përkatëse, mbivlerëson saldon e llogarive të arkëtueshmeve dhe nënvlerëson lejimet në pasqyrën e të ardhurave. Ne sipas procedurave alternative të auditimit nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse kompania ka zbatuar politikën e provizionimit konform kërkesave të SNRF 9.

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomali mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidencën e auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.

- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuara gjatë auditimit tonë.

Lulzim Berisha
Auditor ligjor

Baker Tilly Kosovo
19 prill 2019



 **bakertilly**
Baker Tilly Kosovo L.L.C.
Prishtinë

N.H IBËR LEPENC SH.A


PAQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

Me 31 dhjetor		2018	2017
	Shënimi		
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, impiantet dhe pajisjet	6	113,333,055	117,741,048
Investimi në vijim		70,244	-
Gjithsej		113,403,299	117,741,048
Pasuritë afatshkurta			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	1,636,184	1,689,212
Parapagimet dhe kërkesat tjera	8	22,060	16,371
Stoqet	9	1,207,288	1,222,748
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	10	2,265,558	388,354
Gjithsej		5,131,090	3,316,684
GJITHSEJ PASURITË		118,534,389	121,057,732
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	11	25,000	25,000
Fitimi (humbja) mbajtur		(42,557,934)	(38,281,442)
Fitimi (humbja) neto e vitit		(2,944,890)	(4,276,492)
Rezerva e rivlerësimit		162,424,909	162,424,909
Gjithsej		116,947,085	119,891,975
Detyrimet afatgjata			
Huamarrjet	12	500,000	-
Të hyrat e shtyra	13 / 13.1	481,418	490,766
Gjithsej		981,418	490,766
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	14 / 14.1	538,554	432,649
Tatimet e pagueshme	15	38,031	33,356
Detyrimet ndaj personelit	16	29,301	208,986
Gjithsej		605,886	674,991
EKUITETI DHE DETYRIMET		118,534,389	121,057,732

Këto pasqyra financiare janë miratuar dhe nënshkruar nga:


Kryeshefi ekzekutiv
Berat Lushtaku


Zyrtar kryesor financiar
Sami Velju

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 23 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

N.H IBËR LEPENC SH.A

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2018	2017
	<i>Shënimi</i>		
Të hyrat	17	5,251,304	4,148,962
Të hyrat tjera	17.1	34,544	55,195
Gjithsej		5,285,848	4,204,157
Shpenzimet e zhvlerësimit	6 / 6.1	4,604,028	4,643,866
Shpenzimet e personelit	18	2,840,789	3,052,870
Shpenzimet administrative	19	158,454	171,985
Shpenzimet operative	20	405,158	492,982
Shpenzimet e taksave	21	222,308	118,946
Gjithsej		8,230,737	8,480,649
Të hyrat (dalat) financiare		-	-
Fitimi (humbja) para tatimit		(2,994,889)	(4,276,492)
Tatimi në fitim - 10 %		-	-
Fitim (humbja) neto gjithëpërfshirëse e vitit		(2,994,889)	(4,276,492)
<i>Fitimi para interesit, taksave dhe zhvlerësimit</i>		1,659,139	367,374
<i>Rritja (zvogëlimi) në % nga periudha paraprake</i>		31%	9%

Humbja gjithëpërfshirëse e cila përcjellet nga periudhat paraprake është për shkak të zhvlerësimit të lartë gjatë viteve. Shpenzimi i zhvlerësimit paraqet një zë jo-monetar sa i përket rrjedhjeve të parasë, por që ndikon drejtëpërdrejtë në rezultatin e fundivitetit.

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 23 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

N.H IBËR LEPENC SH.A

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUTITET

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

	Kapitali Aksionar	Fitimi (Humbja) e akumuluar	Rezerva e rivalorizuar	Gjithsej
Bilanci me 31 dhjetor 2015	25,000	(33,687,179)	-	(33,662,179)
Fitimi/(humbja) e vitit	-	(4,594,263)	-	(4,594,263)
Shtimi i kapitalit	-	-	-	-
Dividenda e paguar	-	-	-	-
Bilanci me 31 dhjetor 2016	25,000	(38,281,442)	162,424,909	124,168,467
Fitimi/(humbja) e vitit	-	(4,276,492)	-	(4,276,492)
Shtimi i kapitalit	-	-	-	-
Dividenda e paguar	-	-	-	-
Bilanci me 31 dhjetor 2017	25,000	(42,557,934)	162,424,909	119,891,975
Fitimi/(humbja) e vitit	-	(2,944,889)	-	(2,944,889)
Shtimi i kapitalit	-	-	-	-
Dividenda e paguar	-	-	-	-
Bilanci me 31 dhjetor 2018	25,000	(45,502,823)	162,424,909	116,947,086

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 23 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

N.H IBË-R LEPENC SH.A

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018 (Vlerat e shprehura në euro)

Për vitin që përfundon me:		2018	2017
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	<i>Shënimi</i>		
Fitimi (humbja) neto e vitit		(2,944,889)	(4,276,492)
<i>Të korrigjuara për:</i>			
Zhvlerësimi (me rregullimet për heqjet)	6 / 6.1	4,585,667	4,573,531
(Rritja)/zvogëlimi provizioneve		-	-
Fitim (humbje) nga shitja kapitale		-	-
Fitimi (humbja) para interesit, tatimit dhe zhvlerësimit		1,640,778	297,039
Lëvizjet në kapitalin qarkullues			
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	7-8	47,338	(210,550)
(Rritja)/zvogëlimi në stoqe	9	15,460	40,449
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	15	(69,106)	69,147
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)		1,634,470	196,085
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet (shitjet) e pronës, impianteve dhe pajisjeve	6	(195,338)	(99,058)
Shitjet (heqjet) e pronës, impianteve dhe pajisjeve	6	19,439	72,694
Investimet tjera në pronë, impiante dhe pajisje	6.1 / 12	(72,019)	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)		(247,918)	(26,364)
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Të hyrat e shtyra	13 / 13.1	(9,347)	13,097
Huamarrjet	12	500,000	-
Tërheqjet e fitimit		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)		490,653	13,097
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)		1,877,204	182,818
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	10	388,353	205,536
VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit (IV + V)		2,265,558	388,353

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 23 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

N.H IBËR LEPENCI SH.A

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

N.H "Ibër-Lepenc" SH.A. » është konstituar në vitin 1986 si Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes të infrastrukturës të këtij sistemi shumë funksional. Më vonë është transformuar në Ndërmarrje Publike nga UNMIK-u. Në vitin 2007 me përfundimin e korporatizimit ndërmarrja ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore. Në vitin 2007 në "Ibër Lepenc" ka përfunduar procesi i korporatizimit me të cilin është kryer edhe procesi i vlerësimit të asetëve dhe kështu nga data 1 janar 2008 ndërmarrja është regjistruar si shoqëri aksionare me emrin NH "Ibër Lepenc" – Sh.A. Prishtinë. Në ndërkohë, me kërkesë të Njesisë për Politika dhe Monitorin të Ndërmarrjeve Publike, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74 të datës 14.07.2009 dhe Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1 të datës 30.09.2009, më 22.10.2009, janë kryer ndryshimet në statutin e ndërmarrjes sipas të cilave është shuar ish Ndërmarrja Holding dhe është sqaruar se NH "Ibër-Lepenc" SH.A. është trashëgimtare e ish-Ndërmarrjes Publike dhe ish-Ndërmarrjes Holding. Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ndërmarrja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili ka kompetenca ekzekutive e që njëherit është edhe zyrtari më i lartë në ndërmarrje. Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/ L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të rëndësishme të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes.

Vepërtaria kryesore : furnizimi me ujë të patrajtuar për qëllime të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore, për kompanitë rajonale të ujësjellësve, për shfrytëzuesit industrial dhe gjeneron energji elektrike nga hidrocentrali në Ujman.

Numri mesatar i të punësuarve për vitin 2018 është 274.

Selia qendrore e ndërmarrjes është në Prishtinë, Sheshi "Bill Clinton", nr.13, Kosovë.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklaratë e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Valuta raportuese në evidencën e NH "Ibër-Lepenc" SH.A. dhe pasqyrat financiare është valuta Euro (€). Transakcionet në valuta tjera përveç euros nëse ka pasur janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transakcioneve.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të ardhurave dhe të shpenzimeve.

N.H IBËR LEPENCI SH.A

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

2. BAZAT E PËRGATITJES

(j) Hipoteza e vijimësisë

Ndërmarrja ka të aprovuar planin trevjeçar 2018-2021 ku janë paraqitur synimet dhe objektivat e ndërmarrjes në zgjerimin e veprimtarisë, rritjen e asetëve dhe shfrytëzimin më të madh të kapaciteteve që do të siguronin edhe ngritjen e të hyrave gjatë tri viteve të ardhshme.

Pasqyra e pozicionit financiar dhe Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë përgatitur sipas supozimit të vijimësisë, e cila supozon se Kompania do të jetë në gjendje të realizon pasuritë e saj dhe të përmbushë obligimet në operacionet normale të biznesit. Edhe pse ndërmarrja N.H Ibër Lepenci Sh.a gjatë vitit 2018 ka gjeneruar humbje nuk kemi gjetur pasiguri materiale të theksojmë vijimësinë e ndërmarrjes. Humbja e gjeneruar rrjedh si pasojë e shpenzimit vjetor të zhvlerësimit. Rrjedhjet e parasë janë vëzhguar dhe është analizuar që hyrjet/daljet e parasë janë në raportin e dëshiruar që kompania të ruajë likuiditetin e saj përkundër faktit se në aspektin e rrjedhës së parasë shpenzimi i zhvlerësimit vjetor është zë-jomonetar. Fitimi para zhvlerësimit, taksave dhe interesit është përmisuar dukshëm në krahasim me periudhën paraprake (*rritje prej 31%*). Performanca e ndërmarrjes për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, paraqet një performancë dukshëm më të mirë se 2 vitet e kaluara, e cila është dëshmi e mjaftueshme se pohimi i vijimësisë është përmbushur nga ana e ndërmarrjes.

3. Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar

Kompania ka zbatuar SNRF 15 dhe SNRF 9 nga 1 janari 2018. Një numër standardesh të tjera të reja kanë efekt gjithashtu nga 1 janari 2018, por ato nuk kanë një efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

Për shkak të metodave të tranzicionit të zgjedhura nga Kompania në zbatimin e këtyre standardeve, informacioni krahasues në të gjitha këto pasqyra financiare nuk është riparaqitur për të pasqyruar kërkesat e standardeve të reja.

SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët

SNRF 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të hyrat njihen. Ky standard zëvendësoi SNK 18 *Të hyrat*, SNK 11 *Kontratat ndërtimore* dhe interpretimet përkatëse. Sipas SNRF 15, të hyrat njihen kur një klient merr kontrollin e mallrave ose shërbimeve. Përcaktimi i kohës së transferimit të kontrollit - në një moment ose me kalimin e kohës - kërkon gjykim.

Kompania ka adoptuar SNRF 15 duke përdorur metodën e efektit kumulativ, me efektin e zbatimit fillestar të këtij standardi të njohur në datën e aplikimit fillestar (dmth 1 janari 2018). Prandaj, informacioni i paraqitur për vitin 2017 nuk është riparaqitur - dmth është paraqitur siç është raportuar më parë, sipas SNK 18, SNK 11 dhe interpretimet përkatëse. Përveç kësaj, kërkesat e shpalosjes në SNRF 15 nuk janë zbatuar në përgjithësi në informacionin krahasues.

SNRF 15 nuk ka pasur një ndikim të rëndësishëm në politikat kontabël të Kompanisë në lidhje me rrjedhat e të hyrave.

SNRF 9 Instrumentet financiare

SNRF 9 parashton kërkesa për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa kontratave për të blerë ose shitur artikujt jofinanciar. Ky standard zëvendëson SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*.

Si rezultat i adoptimit të SNRF 9, Kompania ka adoptuar ndryshime konsekuente në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, të cilat kërkojnë zhvlerësimin e aktiveve financiare të paraqiten në një zë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të hyrave tjera gjithëpërfshirëse. Më parë, qasja e Kompanisë ishte që të përfshinte zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare në shpenzime të tjera.

Përveç kësaj, Kompania ka miratuar ndryshime konsekuente në SNRF 7 *Instrumentat Financiarë: Shpalosjet* që zbatohen për dhënien e informacioneve shpjeguese rreth vitit 2018, por nuk janë aplikuar në përgjithësi në informacionin krahasues.

N.H IBËR LEPENCI SH.A

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

3.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese të cilat nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese janë publikuar nga BSNK të cilat nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar nga Kompania. Informatat për ndryshimet që pritet të jenë relevante për Kompaninë, janë paraqitur më poshtë.

Menaxhmenti pret se të gjitha publikimet do të adoptohen në politikat kontabël të Kompanisë për periudhën e parë që fillon pas datës efektive të publikimeve. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë adoptuar ose nuk janë listuar më poshtë nuk pritet të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNRF 16 Lizingu

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënësit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jashtë bilancit) dhe lizingut financiar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përveç për lizingjet afatshkurta dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

SNRF është efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofroj informata të kuantifikuara.

N.H IBËR LEPENCI SH.A

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

4. POLITIKAT DOMETHËNËSE TË KONTABILITETIT

a. Prona, Pajisjet dhe Impiantet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pasurive joqarkulluese paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e pasurisë. Kur pjesë të një elementi të pasurive joqarkulluese të kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të vecanta të pasurive joqarkulluese.

Artikujt e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve deri me 01 Janar 2008 prezantohen në pasqyrat financiare sipas koston së vlerësuar minus çdo amortizim dhe humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, përderisa artikujt e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve të blera pas 01 Janarit 2008 vlerësohen sipas modelit të rivlerësimit që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëposhëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim

Kostoja e vlerësuar paraqet vlerat fillestare të aseteve të vlerësuara nga Ndërmarrja me ndihmën e një konsulenti të pavarur (PC&A) më 31 Dhjetor 2007.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rrjedhin për Ndërmarrjen dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të pasurive joqarkulluese njihet me vlerën bartur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhme që i atribuohen atij elementi do t'i perkasin Kompanisë, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme të aktiveve. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) janë rivlerësuar në datën e raportimit.

Sipas përcaktimit të vlerësuesve të pavarur gjatë rivlerësimit të jetës së përdorimit të mjeteve themelore dhe pajisjeve, shkallët e zhvlerësimit dallojnë nga shkallët e zhvlerësimit sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi:

		Shkallët e zhvlerësimit sipas vlerësuesve								Sipas Ligjit Nr.03/L-113 dhe A. Tatimore
		Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014	Viti 2013	Viti 2012	Viti 2011	
1	Ndërtesat	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	1% - 2%	5%	
2	Pajisjet e rënda industriale	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	5% - 15%	5%-15%	5% - 15%	10%	
3	Veturat	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	5% - 20%	5%-20%	5% - 20%	20%	
4	Pajisjet për zyre dhe kompjuterë	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	10% - 20%	10%-20%	10% - 20%	20%	

N.H IBËR LEPENCI SH.A

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018

(Vlerat e shprehura në euro)

b. Stoqet

Stoqet vlerësohen sipas kostos më të ulët ose vlerës neto të realizuar, dhe raportohen jo më shumë se shumën e pritur të realizohet nga shitja ose përdorimi. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus kostot e vlerësuara të nevojshme për ta kryer shitjen. Kur kostojat e një artikulli të stoqeve e tejkalon vlerën neto të realizueshme, ky tejkallim do të evidentohet si humbje në pasqyrën e të ardhurave. Kostojat e stoqeve është e përcaktuar në bazë të formulës "I pari Brenda - I pari jashtë" apo FIFO që nënkupton se ndërmarrja stoqet e blera me çmimin e parë i trajton dalje të para..

c. Njohja e të hyrave

Të hyrat maten duke u bazuar në konsideratën e specifikuar në kontrata me konsumatorë dhe përjashton shumën që mbledhen në emër të palëve të treta. Kompania njih të hyrat kur transferron kontrollin mbi produktin ose shërbimin tek konsumatori.

Me qëllim të njohjes së të hyrave, kompania ndjek procesin sipas 5 hapave:

1. Identifikimi i kontratës me konsumatorin
2. Identifikimi i obligimeve të performancës
3. Përcaktimi i çmimit të transaksionit
4. Shpërndarja e çmimit të transaksionit në obligime të performancës
5. Njohja e të hyrave kur përmbushen obligimet e performancës.

Të hyrat njihen ose në një moment në kohë ose brenda një periudhe të caktuar atëherë kur kompania përmundshë obligimet e performancë duke transferruar mallrat ose shërbimet e premtuara.

Shitja e mallrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihet në një moment në kohë atëherë kur konsumatori përfton kontrollin mbi mallrat, që zakonisht është në momentin e dërgesës.

Të hyrat tjera

Të hyrat tjera njihen kur pranohen ose kur e drejta për të pranuar pagesë është përcaktuar.

d. Njohja e shpenzimeve

Njohja e shpenzimeve bëhet vetëm kur pasuritë ekonomike të ndërmarrjes të shoqëruara me transaksione konsumohen për prodhimin e mallrave ose kryerjen e shërbimeve. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave vetëm kur ato ndodhin sipas parimit akrual të kontabilitetit.

e. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Kompania paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur arrijnë moshën për pension. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Kompanisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Kompania njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

N.H IBËR LEPENCI SH.A

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018
(Vlerat e shprehura në euro)

f. Kontributi shtesë për të punësuarit

Ndërmarrja duke u bazuar në moshën mesatare të të punësuarve, kontributin e tyre në ndërmarrje, procedurave aktuale të pensionimit, përveç kontributit pensional të obligueshëm sipas legjislacionit në fuqi ka vendosur politika të ndarjes së kontributeve shtesë për të punësuarit. Këto kontribute shtesë i ngarkojnë shpenzimet e pagave në pasqyrat e të ardhurave sipas periudhave kohore kur ndodhin. Që nga muaji Mars 2010, Ndërmarrja ka ndërprerë pagesën e kontributit shtesë për të punësuarit.

g. Politika tatimore

Në bazë të organizimit si ndërmarrje publike me statut të shoqërisë aksionare, ndërmarrja ju nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të cilat rregullojnë lëmi të caktuara në të cilat aplikohet tatimi në vlerën e shtuar, kontributet pensionale dhe tatimi në të ardhura personale si dhe sipas Ligjit Nr.03/L-113 për Tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimi në të ardhurat e tatueshme të korporatave me normë prej 10% i kalkuluar sipas Deklaratës vjetore të tatimit në fitim.

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrështë llogaritur duke përdorur metodën e detyrimit në bilanc, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrështë llogaritur bazuar në metodën e realizimit ose kompensimit të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për atë që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit aktivi të mund të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për atë që nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

h. Njohja e granteve qeveritare

Grantet qeveritare do të njihen vetëm atëherë kur ka siguri të arsyeshme se ndërmarrja do ti plotësojë kushtet e grantit dhe granti do të merret.

i. Politika e rritjes së kontrollit të brendshëm

Pas transformimit në shoqëri aksionare me qëllim të rritjes së kontrollit të brendshëm, ndërmarrja sipas Ligji për Shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/ L-087) ka punësuar Zyrtarin për Auditim të Brendshëm.

j. Instrumentet financiare

